



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2093/ 6 prot.

Datë 15.09.2025

V E N D I M
Nr. 1241 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.09.2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Mbylljen e çështjes për ankesën e operatorit ekonomik “GTS-Gazra Teknike Shqiptare” ShPK për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*”, me Nr. REF-56319-07-25-2025, me objekt “Blerje autoambulanca (me sisteme, paisje dhe aparatura mjekësore) për shërbimin e urgjencës mjekësore për QKUM, me fond limit:146,315,245 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar më datë 08.09.2025 nga autoriteti kontraktor Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore.

Mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “ALBANIA MOTOR COMPANY” ShPK për procedurën e prokurimit sipërcituar

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit prokurimit sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “GTS-Gazra Teknike Shqiptare” ShPK me Nipt, J61905015B, *Adresa: Fabrika e qelqit, Tiranë*

Operatori ekonomik “ALBANIA MOTOR COMPANY” ShPK me Nipt, K41829010I, *Adresa:Kashar, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore.
Adresa: Rr.Lord Bajron, Nr.70, Laprakë, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për*

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetura në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën **28.07.2025**, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-56319-07-25-2025, me objekt “Blerje autoambulanca (me sisteme, paisje dhe aparatura mjekësore) për shërbimin e urgjencës mjekësore për QKUM, me fond limit:146,315,245 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar më datë 08.09.2025 nga autoriteti kontraktor Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5638 datë 05/08/2025 dhe me nr. 2093/2025 prot., datë 05/08/2025 nga operatori ekonomik “GTS-Gazra Teknike Shqiptare” ShPK, me anë të së cilës kërkon modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.2.1. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.3. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5646 datë 06/08/2025 dhe me nr. 2133/2025 prot., datë 07/08/2025 nga operatori ekonomik “ALABNIAN MOTOR COMPANY” ShPK për procedurën e prokurimit objekt ankimi duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3.1. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr. 561 prot., datë 08.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 2093/1, datë 08.09.2025, si edhe protokolluar me nr. 2133/1, datë 08.09.2025, me objekt “Informacion”, dhe autoriteti kontraktor shprehet:

1. Ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë:

“GTS-Gazra Teknike Shqiptare” ShPK me nr. ankimimi elektronik A/2025/5638 dhe nr. 2093/2025 prot., datë 05/08/2025 dhe

“ALABNIAN MOTOR COMPANY” ShPK me nr ankimimi elektronik A/2025/5646 datë dhe me nr. 2133/2025 prot., datë 07/08/2025

nuk kanë mbërritur zyrtarisht tek Autoriteti kontraktor në mënyrë që të protokolloheshin dhe AK të merrte masat e nevojshme për shqyrtimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi.

Më datë 8.09.2025 punonjësi i autorizuar ka konstatuar në SPE, në rubrikën kërkesa, 2 kërkesa të reja nga OE e mësipërm të cilët kërkonin sqarime për shqyrtimin e ankesave dhe pezullimin e procedurës. AK pasi verifikoi në web në faqen e KPP-së këto ankesa, filloi përgatitjen e dokumentacionit për pezullimin e procedurës dhe shqyrtimin e tyre.

2. Por afati i hapjes së ofertave ka kaluar (08.09.2025 ora 11.00).

3. Duke marrë parasysh këtë situatë kërkojmë udhëzim nga KPP për veprimet ligjore të mëtejshme:

Pezullimi i procedurë në mënyrë që të vijojmë me hapat e mëtejshëm për shqyrtimin e ankesave të OE të interesuar.

Ju lutemi të na informoni për veprimin e duhur që të sigurihet respektimi i ligjit dhe shmangia e përgjegjësive për Autoritetin Kontraktor.

II. 5 Me shkresat ardhur me e-mail dhe me postë me Nr. 568 Prot., datë 10.09.2025, protokolluar me tonën me Nr. 2093/2, datë 11.09.2025 dhe nr.2093/3 datë12.09.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë vendimin e KSHA-së mbi pranimin pjesërisht të pretendimeve të ngritura në ankesat e operatorëve ekonomikë ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “GTS-Gazra Teknike Shqiptare” ShPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, sa i përket:

Ne procesverbalin për Argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim është përcaktuar

7. Duke qene se autoambulancat duhet te kenë garanci nga prodhuesi ose distributori i autorizuar prej tij 2 vjet, per pjesen motorrike, mekanike elektrike e të tjerë, OE, duhet të paraqesi nje preventiv të shërbimeve të mirëmbajtjes profilaktike periodike që kanë të nevojshme këto autoambulanca për periudhën e garancisë. Këto oferta nuk janë pjesë e çmimit të blerjes së autoambulancave, por shërbejnë për parapërgatitjen e AK me qëllim ruajtjen e kushteve të garancisë

Në gjuhën anglisht

7. operator for the vehicles offered, where the warranty period is defined as no less than 4 (four) years or 100,000 km .

Në dokumente e tenderit shtojca Kriteret për Kualifikim

1. *Në gjuhën shqipe “Duke qene se autoambulancat duhet te kenë garanci nga prodhuesi ose distributori i autorizuar prej tij 2 vjet, per pjesen motorrike, mekanike elektrike e të tjerë, OE, duhet të paraqesi nje preventiv të shërbimeve të mirëmbajtjes profilaktike periodike që kanë të nevojshme këto autoambulanca për periudhën e garancisë. Këto oferta nuk janë pjesë e çmimit të blerjes së autoambulancave, por shërbejnë për parapërgatitjen e AK me qëllim ruajtjen e kushteve të garancisë”*

2. *Në gjuhën anglisht “Since ambulances must have a 2-year warranty from the manufacturer or its authorized distributor for the motor, mechanical, electrical and other parts, the EO must submit an estimate of the periodic preventive maintenance services with a list of items and their respective prices that these ambulances need for the warranty period.*

These offers are not part of the purchase price of the ambulances, but serve to prepare the CA in order to maintain the warranty conditions”.

Sa me sipër kërkojme ndryshimin e kriterit në të dyja gjuhët.

- Autoriteti Kontraktor me Vendimin e KSHA-së ka pranuar pretendimin e ankimesit mbi vitet e garancisë për Autoambulancat si vijon:

Ankesa 6: Pranohet

1. në gjuhën shqipe. Duke qene se autoambulancat duhet te kenë garanci nga prodhuesi ose distributori i autorizuar prej tij 2 vjet, per pjesen motorrike, mekanike elektrike e tjer, OE, duhet te paraqesi nje preventiv te sherbimeve të mirëmbajtjes profilaktike periodike me listë artikujsh dhe çmimet përkatëse që kanë të nevojshme këto autoambulanca për periudhën e garancisë. Këto oferta nuk janë pjesë e çmimit të blerjes së autoambulancave, por shërbejnë për parapërgatitjen e AK me qëllim ruajtjen e kushteve të garancisë.

2. në gjuhën anglisht. Since ambulances must have a 2-year warranty from the manufacturer or its authorized distributor for the motor, mechanical, electrical and other parts, the EO must submit an estimate of the periodic preventive maintenance services with a list of items and their respective prices that these ambulances need for the warranty period. These offers are not part of the purchase price of the ambulances, but serve to prepare the CA in order to maintain the warranty conditions

Sqarim: Garancia është ajo që i referohet gjuhës shqipe, 2 VJET

III.1.1 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes "GTS-Gazra Teknike Shqiptare" ShPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, sa i përket:

Autoriteti kontraktor ka kërkuar në kriteret për kualifikim:

7. Operatori ekonomik duhet të disponojë një **inxhinier mekanik** të diplomuar me eksperiencë të mëparshme në fushën e montimit dhe përshtatjes së pajisjeve mjekësore në automjete ose në furnizimin e automjeteve të specializuara për përdorim mjekësor.

Dokumentacioni që kërkohet:

- Diplomë universitare në fushën e inxhinierisë mekanike (ose ekuivalente).
- Certifikatë specializimi për këtë qëllim.
- Kontratë punësimi e vlefshme .

Duke qene se objekti i prokurimit eshte "Blerje autoambulanca (me sisteme, paisje dhe aparatura mjekësore) për shërbimin e urgjencës mjekësore për QKUM, për të provuar përshtatshmerine e OE për të realizuar e kryer furnizimin, disponimi i inxhinierit mund të jete jo vetem mekanik por edhe ose inxhinier biomjekësor me eksperience ne fushen e montimit dhe përshtatjes se pajisjeve mjekësore ne automjetet ose ne furnizimet e automjeteve të specializuara për përdorim mjekësor. Nga ana tjetër në vendet e BE-se mbijetojnë blihen nga koncesionare dha asistohen nga teknike të mesme të specializuara në përfundim kërkojnë modifikim të kriterit:

TË BËHET

7. Operatori ekonomik duhet të disponojë një inxhinier mekanik/biomjekësor ose teknik të mesëm të specializuar me eksperiencë të mëparshme në fushën e montimit dhe përshtatjes së pajisjeve mjekësore në automjete ose në furnizimin e automjeteve të specializuara për përdorim mjekësor.

Dokumentacioni që kërkohet:

- Diplomë universitare në fushën e inxhinierisë mekanik/biomjekësore (ose ekuivalente).
- Certifikatë specializimi për këtë qëllim.
- Kontratë punësimi e vlefshme .

- Autoriteti Kontraktor me Vendimin e KSHA-së ka pranuar pretendimin e ankimesit:

Ankesa 5: Operatori GTS Pranohet.

Operatori ekonomik duhet të disponojë një inxhinier mekanik/biomjekësor ose teknik të mesëm të specilizuar, me eksperiencë të mëparshme në fushën e montimit dhe përshtatjes së pajisjeve mjekësore në automjete ose në furnizimin e automjeteve të specializuara për përdorim mjekësor.

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115, pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuara i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.

III.1.4. Për këtë arsye, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “GTS-Gazra Teknike Shqiptare” ShPK me numër ankimi elektronik A/2025/5638 datë 05/08/2025 dhe me nr. 2093/2025 prot., datë 05/08/2025, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-56319-07-25-2025, me objekt “Blerje autoambulanca (me sisteme, paisje dhe aparatura mjekësore) për shërbimin e urgjencës mjekësore për QKUM, me fond limit:146,315,245 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar më datë 08.09.2025 nga autoriteti kontraktor Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore.

Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e procedurës së prokurimit (DST shqip dhe DST anglisht) duke unifikuar ato në lidhje me vitet e garancisë si edhe modifikimet e kriterit 2.3/7 me shtojcë, sipas vendimit të KSHA-së, me qëllim që të njihen të gjithë operatorët ekonomikë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “ALABNIAN MOTOR COMPANY” ShPK mbi modifikime të specifikimeve teknike e konkretisht:

Konkretisht në pikën 2.3 Kapaciteti teknikë, nenpika 5 operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në shtojcën 6 të DST-së.

Ne shtojcën 6 I-SPECIFIKIMET TEKNIKE TË AUTOAMBULANCAVE ME SISTEME, PAJISJE DHE APARATURA MJEKËSORE.

Pika B-Karakteristikat e automjetit, janë cilesuar specifikime teknike specifike si me poshte:
Cilindrata jo më pak se 2100cc

Gjatësia maksimale 5.413 mm [...] *kerkojme rishikimin e specifikimeve teknike ne menyre qe ato te jene te hapura, gjithesepershireshe dhe te bazuara ne performance, jo ne karakteristika te nje modeli te vetem. Te eliminohen kufizimet e panevojshme si dimensionet fikse, kambio automatike e detyrueshme, dhe cilindrata e caktuar pa justifikim teknik. [...]*

- Autoriteti kontraktor me Vendimin e KSHA-së ka pranuar të modifikojë parametrat konkretisht:

Cilindrata jo më pak se 2000cc

Gjatësia maksimale 5000 mm-6000 mm.

III. 2.1. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.2.2. Neni 115, pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuara i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës,
Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.

III.2.3. Për këtë arsye, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “ALABNIAN MOTOR COMPANY” ShPK me numër ankimi elektronik A/2025/5646 datë 06/08/2025 dhe me nr. 2133/2025 prot., datë 07/08/2025, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-56319-07-25-2025, me objekt “Blerje autoambulanca (me sisteme, paisje dhe aparatura mjekësore) për shërbimin e urgjencës mjekësore për QKUM, me fond limit: 146,315,245 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar më datë 08.09.2025 nga autoriteti kontraktor Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore.

Komisioni do të vijojë me shqyrtimin në themel të pretendimeve të tjera të ngritura në ankesë

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “ALABNIAN MOTOR COMPANY” ShPK mbi modifikime të specifikimeve teknike e konkretisht:

Konkretisht në pikën 2.3 Kapaciteti teknikë, nën pika 5 operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në shtojcën 6 të DST-së.

Ne shtojcën 6

**-SPECIFIKIMET TEKNIKE TË AUTOAMBULANCAVE ME SISTEME,
PAJISJE DHE APARATURA MJEKËSORE.**

Pika B-Karakteristikat e automjetit, janë cilesuar specifikime teknike specifike si me poshte:

Kambio automatike

Gjerësia maksimumi 2.050 mm duke përjashtuar pasqyrat

Lartësia maksimumi 2.600 mm duke përfshirë antenat e radios

Hapja e pasme

Hapja e pasme përmes derës së dyfishtë (lartësia 1500 mm/gjerësia 1050 mm) Hapja duhet të marrë parasysh dimensionet e barelave, siç përcaktohet nga standardi SSH EN 1865 dhe UNI EN 1789+ A2 2014. Hapja e derës deri në 270°.

Kamera e pasme dhe kamera në gabinën e pacientit e kompletuar me monitor të integruar në kroskotin në kabinën e shoferit.

Ne eksperiencën tone si një prej ofruesve lider në tregun e Automjeteve i kundërshtojmë specifikimet teknike me siper dhe kërkojmë të rishikohen pasi me bindje konstatojmë se specifikimet e vendosura të drejtojnë drejt një modeli të caktuar automjeti duke e kthyer

proceduren ne nje procedure prokurimi abuzive dhe ne shkelje te legjislacionit aktual te prokurimit publik, duke kufizuar pjesemarrjen e operatoreve ekonomike te interesuar.

Se dyti, verehet mosperputhje me praktikat e meparshme te vete autoritetit kontraktor. Me konkretisht, ne proceduren e zhvilluar me date 13/07/2023, me numer reference REF-72217-06-12-2023, dhe objekt kontrate: Blerje Autoambulanca Per Sistemin Shendetesor.

Argumente mbi shkeljet:

Kombinimi i ketyre kritereve kufizon artificialisht konkurrencen, duke e orientuar proceduren drejt nje modeli te vetem automjeti dhe duke perjashtuar prodhues dhe operatore te tjere potenciale, Gjithashtu ne dokumentet e tenderit mungon nje studim teknik qe provon pse:

Cilindrata jo më pak se 2100cc

Kambio automatike

Gjatësia maksimale 5.413 mm

Gjerësia maksimumi 2.050 mm duke përjashtuar pasqyrat

Lartësia maksimumi 2.600 mm duke përfshirë antenat e radios

Kamera e pasme dhe kamera në gabinën e pacientit e kompletuar me monitor të integruar në kroskotin në kabinën e shoferit

Duke shkaktuar nje sere pasojash si:

- Kufizim i numrit te ofertuesve potencial
 - Rritje e mundshme e Cmimit final per shkak te mungeses se konkurrences
 - Cenim i perdorimit eficient te fondeve publike dhe i besimit publik ne procesin e prokurimi.
- Ne baze te sa me sipër, kërkojme
- Rishikimin e specifikimeve teknike ne menyre qe ato te jene te hapura, gjithepërfshtrese dhe te bazuara ne performance, jo ne karakteristika te nje modeli te vetem.
 - Te eliminohen kufizimet e panevojshme si dimensionet fikse, kambio automatike e detyrueshme, dhe cilindrata e caktuar pa justifikim teknik.
 - Te harmonizohen kriteret me praktikat e meparshme te autoritetit kontraktor dhe me parimet e konkurrences se ndershme.

Në përgjigjen sqaruese: keni parashtruar qe jeni mbeshetur në standartet europiane përkatëse EN 1789, SSH 1789 etj, por këto standarte nuk kufizojnë minimum dhe maksimum të dimensioneve të jashtëme të mjeteve apo cilindrates së motorrave

Mjafton që ato të jenë mjete të homologuar me COC Evropiane. Në keto standarte pasqyrohen vetëm minimum të dimensioneve të kompartmentit të pacientit mbrapa, me qëllim për të realizuar hapsirën e mjaftueshme për vendosjen e aparaturave të nevojshme sipas kërkesës për tipin A-B ose C.

Autoriteti kontraktor, vërtetë ka të drejtë të kërkojë parametra të përcaktuar për performancë, por jo të penalizojë pjesëmarrjen e brandeve të tjera pervec atyre te Grupi Stelantis, për sa kohë që mjetet janë të homologuara dhe përputhen me standardet e BE-së, si për emetimet edhe per sigurinë.

Te cili standart apo material jeni mbeshetur që keni dalë në konklusionin se

Motorrët 1.9-2.0 lit me 130,150 apo 165 Kf nuk e realizojne akselerimin e kërkuar per mjetin autoambulance. Mungese justifikimi teknik.

III.3.1. Autoriteti kontraktor ka përcaktuar me shtojcën 6, FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE, si vijon:

B. Karakteristikat e automjetit.

Viti i prodhimit 2025

Modeli 2025

Cilindrata jo më pak se 2100cc

Fuqia të paktën 170 kt (Cv) (të paktën 103 KW)

Klasa dhe emetimi i gazrave: Euro 6

Norma e CO²: Euro 6, sipas kategorisë së automjetit

Sistemi i drejtimit me 4 rrota me një aks aktiv (2x4)

Kambio automatike

Timoni idraulik

Vendi i drejtuesit: Në të majtë

Motorri turbodiesel me injeksion direkt common rail ose ekuivalente

Versioni: Furgon me dritare (nuk lejohen kontejnerët/modulet ose ndarjet e gabinës së pacientit të pavarura nga kabina e shoferit)

Shpejtësia nga 0 në 80 km/h në një maksimum prej 30-35 sekondash me ngarkesë të plotë - siç kërkohet nga SSH UNI EN 1789+ A2 2014

Grupimet e dritës: Grupet e dritave të përparme dhe ndriçues për indietron.

Sediljet e gabinës së shoferit. Nr. 2 sedilje teke të rregullueshme në lartësi, të ndara, të pajisura me mbështetëse krahu, mbështetëse koke dhe mbështetje mesit.

Dimensioni. Kalim të mesëm

Strukturë stabilizuese e përparme me ekran 10" me integrimin e smartfonëve

Bateri me fuqi të shtuar,

Dinamo me fuqi të shtuar

Gjatësia maksimale 5.413 mm

Gjerësia maksimumi 2.050 mm duke përfshirë pasqyrat

Lartësia maksimumi 2.600 mm duke përfshirë antenat e radios

Kapaciteti deri në 35 quintal(kv)

Gabina e shoferit me dy dyer.

Hapja e pasme

Hapja e pasme përmes derës së dyfishtë (lartësia 1500 mm/gjerësia 1050 mm) Hapja duhet të marrë parasysh dimensionet e barelave, siç përcaktohet nga standardi SSH EN 1865 dhe UNI EN 1789+ A2 2014. Hapja e derës deri në 270°.

Kamera e pasme dhe kamera në gabinën e pacientit e kompletuar me monitor të integruar në kroskotin në kabinën e shoferit.

III.3.1.1 Referuar P-V “Mbi argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike” Ak ka argumentuar si vijon:

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, për mallin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

III.3.2. Referuar Nenit 2 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Neni 3, “Parime të përgjithshme” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në 5 mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

Neni 36 “Specifikimet teknike” i ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë*

karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet

ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.

III.3.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së Lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, thuhet se: *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/ përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të të orientojnë operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave duke mbajtur në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar në rastin konkret funksionalitetin e pajisjeve objekt prokurimi, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara por edhe duke shmangur çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë, që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ushtrojnë të drejtën e ankimit mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumente të bazuara mbi ato çfarë kërkojnë, përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110, pika 1 të ligjit nr.162/2020.

III. 3.4 Komisioni i Prokurimit Publik referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues, mori në shqyrtim dokumentacionin e tenderit, **shtojcën 6**, Specifikimet Teknike, të publikuar në SPE si edhe vendimit të KSHA-së me anë të së cilës AK nuk ka pranuar pretendimet e operatorit ekonomik në lidhje me modifikimin e parametrave si vijon:

Gjerësia maksimumi 2.050 mm duke përjashtuar pasqyrat

Lartësia maksimumi 2.600 mm duke përfshirë antenat e radios

Hapja e pasme përmes derës së dyfishtë (lartësia 1500 mm/gjerësia 1050 mm).

Komisioni në analizë të dokumenteve thekson se, autoriteti kontraktor, në hartimin e specifikimeve teknike, duhet të evitojë përcaktimet dhe parametra me vlera fikse, në lidhje me artikujt objekt prokurimi, në mënyrë që të mos ketë asnjë element që të çon në kufizimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Komisioni, referuar Procesverbalit: *“Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim”*, konstatoi, se Autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar vendosjen e specifikimeve teknike në tërësi dhe në veçanti të specifikimeve të ankimuara nga operatori ekonomik si rrjedhojë ka përcaktuar parametra me vlera fikse, çka ka sjellë ankesë në lidhje me këto përmasa fikse.

Komisioni referuar pretendimeve të ngritura në ankesë konstatoi se operatori ekonomik me të drejtë ngre pretendime mbi modifikimet e tyre të duke sugjeruar vlera me diapazon minimum/maksimum, në kuadër të hapjes së konkurrencës, me qëllim ofertime me marka të ndryshme konkuresse në treg, duke eliminuar orientimin drejt markave të parapërcaktuara.

Përsa më sipër Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikim të parametrave objekt ankimi duke vendosur parametra me diapazon, pa cënuar funksionimin e automjeteve objekt prokurimi.

Gjithashtu autoriteti të pasqyrojë në shtojcë edhe sqarimet e dhëna nga KSHA.

Përsa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

III.6. Në lidhje me pretendimet e ankimuesit mbi parametrin objekt ankimi **Kambio automatike**, për të cilin argumenton:[...] *përse Kambioja duhet të jetë vetëm kambio automatike e detyrueshme pa justifikim teknik,... i cili përjashton prodhues dhe operatorë potenciale duke orientuar drejt një modeli të caktuar [...]* Komisioni në shqyrtim të dokumenteve të Tenderit e konkretisht Procesverbalit “Mbi Argumentimin e kritereve për kualifikim dhe Specifikimeve teknike”, vëren se vendosja e specifikimeve teknike në tërësi nuk është argumentuar nga autoriteti kontraktor.

Gjithashtu me Vendimin e KSHA-së, AK nuk ka pranuar modifikim të parametrin duke argumentuar se:[...] *Përdorimi i kambios automatike është përcaktuar për të garantuar efikasitet operacional, komoditet për drejtuesin e mjetit dhe kontroll më të mirë në trafikun urban dhe situatat emergjente. Shoferët e ambulancës operojnë në kushte të rënduara trafiku dhe me nevojë për përqendrim të plotë. Kjo zgjidhje është tashmë standard në shumicën e shërbimeve moderne të emergjencës në BE. Për më tepër, teknologjitë e reja kanë reduktuar ndjeshëm dallimet e emetimeve ndërmjet kambios automatike dhe manuale. Mbi 80% e autoambulancave të blera deri tani në Shqipëri, kanë djegur freksionin brenda një viti, ose dy tre herë brenda garancisë, e cila nuk përfshin mbulimin e këtij defekti, duke rritur shpenzimet e ambulancave dhe mirëmbajtjen tejmasë. Ato nuk janë karakteristika vetëm të një modeli dhe nuk penalizojnë konkurrencën pasi këto kritere plotësohen nga shumë operatorë në treg.[...]*

Komisioni konstatoi se operatori ekonomik ka argumentuar drejt pretendimet e tij mbi modifikim të parametrave që autoambulancat të mos jenë vetëm me *Kambio automatike*, në kuadër të hapjes së konkurrencës, me qëllim ofertime me marka të ndryshme konkuresuese në treg, duke eliminuar orientimin drejt markave të përcaktuara.

Komision në analizë të dokumentacionit të dosjes gjykon se, parametri në lidhje me Kambion automatike ose amanele nuk ndikon në funksionalitetin mjetit. Mjetet me kambio automatike vërtet përfaqësojnë teknogjinë e viteve të fundit dhe ndikojnë për një drejtim komod të mjetit por nga ana tjetër këto automjete kanë kosto të larta blerjeje si edhe kosto të larta mirmbajtjeje në raste difektesh, fakt ky që autoriteti kontraktor duhet ta ketë në vëmendje.

Përsa më sipër Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor, në kuadër të hapjes së konkurrencës me marka të ndryshme por me funksione të njejta, në përputhje me qëllimin parësor që kanë këto automjete objekt prokurimi për autoritetin kontraktor, duhet të modifikojë parametrin në lidhje me *Kambio automatike* duke pranuar dhe alternativën tjetër të mënyrës së drejtimit të mjetit.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

III.7. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik mbi modifikim të parametrave me argumente si vijon:

Cilindrata jo më pak se 2100cc, Fuqia të paktën 170 kf (Cv) (të paktën 103 KW)

[...]Autoriteti kontraktor, vërtetë ka të drejtë të kërkojë parametra të përcaktuar për performancë, por jo të penalizojë pjesëmarrjen e brandeve të tjera përveç atyre të Grupi Stelantis, për sa kohë që mjetet janë të homologuara dhe përputhen me standardet e BE-së, si për emetimet edhe për sigurinë.

Te cili standart apo material jeni mbështetur që keni dalë në konklusionin se

Motorrët 1.9-2.0 lit me 130,150 apo 165 Kf nuk e realizojnë akselerimin e kërkuar për mjetin autoambulance. Mungese justifikimi teknik. [...]

- Autoriteti kontraktor me Vendimin e KSHA-së ka pranuar pretendimet duke i modifikuar ato: *[...] Ky parametër siguron fuqi të mjaftueshme për përshpejtim, stabilitet dhe qëndrueshmëri gjatë transportit të pacientëve në urgjencë. Në këto kushte autoriteti kontraktor përcakton: **Cilindrata jo më pak se 2000cc, Fuqia motorrike jo më pak se 170Kf (125 KW).***

Komisioni në analizë të fakteve vëren se: Parametrat Cilindrata dhe Fuqia apo edhe vlera në KW, kanë lidhje midis tyre pasi shërbejnë për të treguar fuqinë e motorrit të automjetit, të cilat në vlera janë në proporcion. Autoriteti kontraktor me vendimin e KSHA-së ka modifikuar cilindrata nga 2100cc në 2000cc, pra duke ulur parametrin, ndërsa në lidhje me vlerën 103 KW, autoriteti kontraktor e ka ngritur nga 103KW në 125 KW.

Komisioni gjykon se Autoriteti kontraktor duhet të rishikojë parametrin e fuqisë së motorrit në proporcion me vlerat e cilindrata të modifikuar nga KSHA.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë pjesërisht.

III.7. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik mbi modifikim të parametrut e konkretisht për:

Kamera e pasme dhe kamera në gabinën e pacientit e kompletuar me monitor të integruar në kroskotin në kabinën e shoferit.

Autoriteti kontraktor me Vendimin e KSHA-së, nuk ka pranuar modifikim të parametrut duke argumentuar se, *Integrimi i kamerave në monitorin e kroskotit. Nuk pranohet*

Sqarim: Pajisjet e fabrikës në automjetet e nivelit të përcaktuar shpesh përfshijnë ekran multimedial me mundësi inputesh video shtesë (AV/USB/CAN). Në këtë rast, kërkesa për monitor të integruar nënkupton që kamera e pasme dhe ajo e kabinës së pacientit të jenë të lidhura dhe kontrollueshme nga ekrani ekzistues, pa pasur nevojë për pajisje shtesë të jashtme. Ky funksion është teknikisht i zbatueshëm dhe i certifikuar nga prodhuesit në versionet që mbështesin këtë opsion

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë specifikime teknike që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Është detyrë e njërive përkatëse të AK-së të mirargumentojnë specifikimet teknike për mallrat që do të prokurojnë, me qëllim që të jenë sa më të plota dhe të sakta, duke dhënë informacionin e nevojshëm për artikujt objekt-prokurimi. Specifikimet teknike duhet të ndihmojnë operatorët ekonomikë në përllogaritjet e kostos së mallit dhe përgatitjen e ofertave të tyre, në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që, në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar të ushtrojnë të drejtë për të ankimuar DST duke parashtruar pretendime mbi modifikimin e kriterëve përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit, por ato duhet të jenë të argumentuar qartë dhe bindshëm mbi çka kërkon konkretisht operatori ekonomik dhe si parametri objekt ankimi ndikon në funksionin e automjeteve objekt prokurimi apo në konkurrencën e operatorëve pjesmarrës të mundshëm në procedurë.

Referuar ankesës së operatorit ekonomik mbi pretendimet për parametrin objekt ankimi, Komisioni konstaton se ankimuesi nuk ka argumentuar qartë së përse ky parametër është kufizues dhe cënon konkurrencën e operatorëve ekonomikë.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet mbi funksionimin me të gjitha opsionet, të automjeteve objekt prokurimi, mbi përmbushjen e qëllimit parësor që ato automjete kanë për autoritetin kontraktor, për një shërbim sa më të mirë në përputhje me misionin për të cilin shërbejnë.

Nga sa më sipër Komisioni gjykon, se argumentet e OE nuk qëndrojnë duke mos arritur që të argumentojë teknikisht pretendimet se si ky parametër ndikon në funksionin e automjetit.

Pretendimet e operatorit ekonomik nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “GTS-Gazra Teknike Shqiptare” ShPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-56319-07-25-2025, me objekt “Blerje autoambulanca (me sisteme, paisje dhe aparatura mjekësore) për shërbimin e urgjencës mjekësore për QKUM, me fond limit: 146,315,245 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar më datë 08.09.2025 nga autoriteti kontraktor Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore.
2. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “ALABNIAN MOTOR COMPANY” ShPK për procedurën e prokurimit sipërcituar.
3. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “ALABNIAN MOTOR COMPANY” ShPK për procedurën e prokurimit sipërcituar.
4. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet dhe sqarimet përkatëse në përputhje me Vendimin e KSHA-së dhe konstatimet e këtij vendimi duke publikuar në SPE shtojcën.
5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifave financiare të paguara nga operatorët ekonomikë “GTS-Gazra Teknike Shqiptare” ShPK dhe “ALABNIAN MOTOR COMPANY” ShPK
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

